



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

NJOFTIM
“PËR ÇELJEN E GARËS PËR DHËNIEN E 1 (NJË) LICENCE TRANSMETIMI AUDIO ANALOGE”

Autoriteti i Mediave Audiovizive (AMA), në mbështetje të ligjit nr. 97/2013 “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, rregullores “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”, miratuar me vendim nr. 7, datë 21.02.2023 të AMA-s, si dhe vendimit nr. 104, datë 21.11.2023 të AMA-s, “Për çeljen e garës për dhënien e licencave të transmetimit audio analoge”, do të organizojë procedurën e përzgjedhjes së kandidaturave për dhënien e 1 (një) licence transmetimi audio analoge, të përbërë nga:

- licenca e shërbimit të programi audio;
- licencë për ndërtimin e operimin e rrjetit analog.

Për zonat e mëposhtme:

Zona e ofrimit të shërbimit	Përcaktimi i operatorit	Pika e transmetimit	Frekuenca MHz	Koordinatat X Y Z	Fuqia Nominale (Ë)	Amplifikimi (dBi)	EIRP (Ë)	Azimuth (deg)	Lartësia e Antentës (m)	Drejtimi Antentës
Bashkia Dibër	Audio Analoge	Arapaj	100.1	20.200 E 41.372 N 4DMS	500	5	1581.13 9	320	15	D
Bashkia Bulqizë	Audio Analoge	Bulqizë	95.7	20.124 E 41.290 N 4DMS	200	5	632.455	Na	15	ND

Subjektet e interesuara për t’u pajisur me licencë transmetimi audio analoge, janë të lutur që të depozitojnë aplikimet në Autoritetin e Mediave Audiovizive, Rruga “Papa Gjon Pali II”, Nr. 15, Kutia Postare 1010, Tiranë, **brenda datës 09.01.2024, ora 10:00.**

Dokumentacioni i plotë i konkurrimit të kandidaturave, që përfshin:

- Rregulloren “Për procedurat dhe kriteret për dhënien e licencës së transmetimit audio analoge”, e ndryshuar;
- Kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi;
- Kriteret teknike për ofrimin e shërbimit audio përfshirë frekuencën/frekuencat dhe pikën/pikat e transmetimit për zonën e shërbimit;

- Pagesat për licencën, tarifat përkatëse dhe mënyrën e pagesës së tyre;

mund të tërhiqet në zyrën e Arkivë-Protokollit, në AMA, pas kryerjes së pagesës në Drejtorinë e Financës dhe Shërbimeve, nga çdo subjekt që synon të marrë pjesë në konkurrim.

Aplikimet do të hapen ***në datë 09.01.2023, ora 10:00, në mjediset e AMA-s***, ku subjektet aplikues apo përfaqësuesit e autorizuar prej tyre, kanë të drejtë të jenë të pranishëm në momentin e hapjes së dosjeve të aplikimit.